

NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/e Aksionerit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Merkrure datë 15.06.2016, ora 12.00 në ambientet e "BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Miratimi i Pasqyrave Financiare vjetore të "Banka Credins" sh.a per vitin 2015 sipas IFRS.
2. Miratimi i Pasqyrave Financiare vjetore të "Banka Credins" sh.a per vitin 2015 sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë
3. Miratimi i Rezultatit Financiar të "Banka Credins" sipas IFRS dhe Bankës së Shqipërisë sh.a per vitin 2015.
4. Propozim për miratimin e ekspertës kontabël të autorizuar Znj.Vera Fazlli Lala për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksioner të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a nëpërmjet kalimit të fitimit të pashpërndare të vitit 2015.
5. Propozim për riemërimin e shoqërisë "Ernst & Young" si ekspert kontabël i autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2016.
6. Propozim për miratimin e emetimit të obligacioneve me kushtet e mëposhtme:
 - a) Vlera totale e emetimit do të jetë 5.000.000 Euro dhe 1.000.000 USD.
 - b) Vlera nominale e obligacioneve të jetë 10.000 Euro dhe 10.000 USD.
 - c) Obligacionet e emetuara janë tituj borxhi që përcaktojnë të drejtën e investitorit për të marrë në datën e maturimit 100% të vlerës nominale të investimit.
 - d) Obligacionet e emetuara në formën e borxhit të varur, nuk do të jenë të garantuara dhe nuk janë subjekt i një garancie që përmirëson prioritetin e pretendimeve sipas nenit 31 të Rregullores "Për kapitalin Rregullator të bankës" miratuar me vendim të Keshillit Mbiqyqres nr.69, datë 18.12.2014, ndryshuar me vendim nr.19, datë 04.03.2015 .
 - e) Obligacionet e Bankës Credins do emetohen me "par value", me cmimin që i korrespondon vlerës nominale të çdo prerje obligacioni. Kjo do të thotë që çmimi i blerjes së tyre është i barabartë me 100% të vlerës nominale. Shumat e obligacioneve janë me prerje minimale në 10,000 (dhjetë mijë) euro dhe 10,000 (dhjetë mijë) Usd.
 - f) Fondet nga shitja e obligacioneve do të përdoren nga emetuesi në aktivitetin e ushtrimit të veprimtarisë së tij dhe veçanërisht në dhënien e kredive të formave të ndryshme si edhe në investime karakteristike të këtij aktiviteti.
 - g) Kohëzgjatja e obligacioneve të jetë 7 vjet. Në bazë Neni-t 39, kreu IV, i Rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për Kapitalin Rregullator të Bankës", Banka e Shqipërisë mund të japë miratimin paraprak të bankës për të shlyer instrumentet e kapitalit të nivelit të parë dhe të dytë, përpara pesë viteve nga data e emetimit të tyre, vetëm kur janë plotësuar kushtet e parashikuara në paragrafin e parë të Neni-t 39, si dhe janë plotësuar kushtet e përcaktuara në shkronjën "a" dhe "b" të paragrafit të tretë të këtij neni.

